



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

Nr. 2462 Prot.

Patos, më 12 / 08 /2025

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM
Nr. 50, datë 12 / 08 /2025

PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2025-2028

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Bazuar në gjurmën k të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nenet 36,45, VKM nr. 111 datë 23.02.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e fondit social”, VKM-në nr. 150 datë 20.03.2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, urdhërit të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit social 2025-2028”,

PROPOZOJ:

1. Miratimin e Planit Social 2025-2028 të Bashkisë Patos, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

GRUPI I PUNËS

Elda Goxhaj

Mimoza Shtëmbari

Barie Goxhaj

Fabjola Dervishaj

Lediana Beqiri

Rovena Dine

Xhemil Muçaj

Ornela Hasanaj

Juriste

Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 2462/Prot
1

Patos, më 12/08/2025

RELACION

PËR

MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2025-2028

Në përmbushje të detyrimeve ligjore për hartimin e planeve lokale dhe në kuadër të grantit të performancës dedikuar bashkive, bashkia Patos ka shprehur angazhimin për hartimin e Planit Social 2025-2028. Ky plan strategjik u hartua nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit social 2025-2028”.

Ligji nr. 121/2016 “Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ngarkon Bashkitë me detyrën e përgatitjes së Planeve Sociale bazuar në nevojat e identifikuara për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e tyre.

Bashkia Patos ka miratuar dy plane sociale: Planin Social 2020-2022 dhe Planin Social 2024-2027, të cilin grupi i punës është mbështetur për hartimin e Planit Social 2025-2028, drafti final i të cilit është konsultuar gjerësisht me grupet e interesit më datë 15.07.2025. Komentet dhe rekomandimet e dhëna janë dokumentuar në procesverbalin e takimit me nr. 1798/1.1 Prot., datë 16.07.2025, të cilat kanë konsistuar kryesisht në detajim të shërbimeve specifike për kategori të caktuara shoqërore. Është rekomanduar ngritja e Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Rasteve si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për personat me probleme të shëndetit mendor.

Identifikimi i nevojave për shërbime të reja të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Patos ka nxitur nevojën për të adresuar dhe priorizuar objektiva të tjera.

Në zbatim edhe të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planin e Veprimit 2025-2030, është synuar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme e përmirësimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Vizioni i këtij plani është krijimi i mundësive për përdorimin e shërbimeve sociale cilësore për të gjithë qytetarët në nevojë në përputhje me nevojat e tyre në çdo njësi administrative të Bashkisë Patos.

Qëllimi strategjik:

Deri në vitin 2028, çdo person dhe familje në territorin e bashkisë Patos, kryesisht ata persona dhe familje të konsideruara në nevojë për shkak të përjashtimit shoqëror ose rrezikut të përjashtimit, do t’ju sigurohet mundësia e barabartë për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror të cilësishme dhe në përputhje me nevojën e tyre, nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të

kujdesit shoqëror, në një mjedis të shëndetshëm, nxitës dhe mbështetës të institucioneve dhe komuniteteve, të gatshme për të realizuar përgjegjësitë e tyre për realizimin e të drejtave sociale.

Objektivat:

Objektiv 1: Përmirësim, zgjerim shërbimesh dhe forcimi i sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, përkujdesit, integritetit dhe përfshirjes për të gjitha grupet në nevojë, të identifikuara dhe vlerësuara si të tilla, në përputhje me standartet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Objektiv 2: Krijimi i një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetësore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.

Objektiv 3: Fuqizim të kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare, teknike të Bashkisë.

Plani i shërbimeve sociale të Bashkisë Patos bazohet në ofrimin e një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë, si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato vendore, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale

Për sa më sipër, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e Planit Social 2025-2028 të Bashkisë Patos, pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij plani ngarkohet Drejtoria e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit dhe Drejtoria e Financës.

GRUPI I PUNËS

Elda Goxhaj



Lediana Beqiri



Mimoza Shtëmbari




Rovena Dine

Barie Goxhaj




Xhemil Muçaj

Fabjola Dervishaj



Ornela Hasanaj





PLANI SOCIAL

2025-2028

Ligji nr. 121/2016 "Mbi shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" ngarkon Bashkitë me detyrën e përgatitjes së Planeve Sociale bazuar në nevojat e identifikuara për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e tyre.

Bashkia Patos ka miratuar dy plane sociale: Planin Social 2020-2022 dhe Planin Social 2024-2027, te i cili grupi i punës është mbështetur për hartimin e Planit Social 2025-2028.

Identifikimi i nevojave për shërbime të reja të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Patos ka nxitur nevojën për të adresuar dhe prioritetizuar objektiva të tjera.

Në zbatim edhe të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale dhe Dokumentit Politik për Moshimin dhe Planin e Veprimit 2025-2030, është synuar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme e përmirësimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Përmbajtja

Lista e tabelave dhe figurave	3
Shkurtesa.....	3
1.HYRJE	4
2. Vlerësimi i arritjeve të Planit Social, 2024-2027.....	5
3. Kuadri llogjik i Planit të Përkujdesit Social, 2025-2028	6
3.1. Baza legjislative	6
3.1 Vizioni.....	8
3.2 Misioni	8
3.3 Vlerat dhe parimet udhërrëfyese	8
3.3.1.Vlerat.....	8
3.3.2. Parimet udhëheqëse	9
3.3.3.Synimet	9
3.3.4 Analiza SËOT	10
4. Analiza e situatës	10
4.1. Të dhëna demografike.....	10
4.2. Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi.....	12
4.2.1. Përfituesit e Ndihmës ekonomike	12
4.2.2.Aftësia e kufizuar	14
4.2.3.Punëkërkuesit e papunë.....	15
4.2.4. Fëmijët e përjashtuar ose në rrezik përjashtimi	16
4.2.5. Gra në situatë kritike.....	18
4.2.6.Të moshuar në situatë kritike	18
4.2.7.Minoritetet etnike.....	19
4.2.8.Të pastrehë.....	19

4.3. Profili i shërbimeve që ofrohen në bashkinë Patos.....	19
4.3.1. Shërbimet dhe institucionet e përkujdesit shoqëror.....	19
4.3.2. Përfituesit e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.....	Error! Bookmark not defined.
4.3.3. Burimet njerëzore, ofruese të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.....	19
4.4. Përmbledhje: Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi	20
5. Fushat strategjike në të cilat duhet të ndërhyjë bashkia nëpërmjet Planit Social 2025-2028	26
5.1. Qëllimi dhe objektivat.....	26
5.2. Plani i veprimit.....	28
5.3. Plani I Integruar I Monitorimit dhe Vlerësimit.....	41

Lista e tabelave dhe figurave

Tabela nr.1: Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit mbështetur në të dhënat e Regjistrit të Gjëndjes Civile

Tabela 2: Popullsia sipas grupmoshave

Tabela 3: Individë përfitues të ndihmës ekonomike në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë si edhe me numrin e aplikantëve të NE, në përqindje

Tabela 4: Përfituesit e ndihmës ekonomike, sipas përbërjes.

Tabela 5: Individët me AK, sipas përbërjes dhe përfitimeve monetare.

Tabela 6: Invalidët e punës, numër dhe përqindje ndaj popullsisë.

Tabela 7: Të dhëna mbi punëkërkuarit e papunë, numër dhe përqindje

Tabela 8: Fëmijë në situatë kritike për shkak të varfërisë dhe AK, në numër dhe përqindje, sipas grupeve dhe njësive administrative.

Tabela 9: Fëmijë në nevojë për mbrojtje

Tabela 10: Numri i grave në situatë kritike

Tabela 11: Përqindja e të moshuarve në situatë të pamjaftueshmërisë të të ardhurave.

Tabela 12: Institucionet e shërbimeve sociale në bashkinë Patos

Tabela 13: Individë në situatë kritike dhe në nevojë për shërbime

Tabela 14: Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuara në raport me numrin e popullsisë

Figura 1: Shpërndarja e Popullsisë sipas njësive administrative të bashkisë në %

Figura 2: Popullsia sipas grup moshave

Figura 3: Përqindja e Individëve me AK sipas njësive administrative.

Figura 4: Përfituesit e shërbimeve sipas grup moshës dhe gjinisë, numër.

Figura 5: Treguesi Përfitues/Staf, raport

Figura 6: Përqindja e individëve në nevojë për shërbime në raport me popullsinë.

Shkurtesa

AK Aftësia e kufizuar

LSMS Studimi mbi matjen e nivelit të jetesës

PAK Pagesa e aftësisë së kufizuar

PK Pagesa e kujdestarisë

1. HYRJE

Bashkia Patos është një bashki e vogël, e krijuar si e tillë pas ndarjes së re territoriale. Ajo kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Fier, në jug me bashkinë Mallakastër dhe në lindje me bashkinë Roskovec. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Patosit. e pas reformës territoriale ka në administrim Njësinë Administrative Zharrëz dhe Njësinë Administrative Ruzhdie. Sipas regjistrit të gjendjes civile, popullsia e Patosit rezulton 42,197 banorë. Territori i bashkisë së re është 82.55 km², i përbërë nga 3 njësi administrative; Patosi, Zharrëza dhe Ruzhdia.

Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 18 fshatra. Baseni naftëmbajtës i njohur si "Patos-Marinza" është historikisht zona më e pasur me naftë në Shqipëri dhe sot vijon të prodhojë shumicën dërrmuese të naftës bruto në vendin tonë. Për shumë vite burimi kryesor ekonomik ka qenë sektori naftënxjerrës. Tanimë po shohim një përqendrim gjithnjë e më të madh tek sektori i bujqësisë dhe agrikulturës. Sipas të dhënave tashmë, përveç ish komunës Zharrës, zonat e tjera si Patosi dhe Ruzhdia kanë si burim kryesor ekonomik kultivimin e ullirit dhe tregtimin e nënprodukteve të tij, të cilat favorizohen dhe nga vetë relievi kodrinor i kësaj zone.

Reforma e re administrative-territoriale ka sjellë një sërë ndryshimesh në kompetencat e njësive të qeverisjes vendore si në shtrirje ashtu edhe në krijimin dhe administrimin e shërbimeve në nivel vendor. Shërbimet e kujdesit shoqëror tashmë konsiderohen si funksion i vetë pushtetit vendor, të decentralizuara, edhe pse këto shërbime të kujdesit shoqëror, do vazhdojnë të kenë mbështetjen teknike, institucionale dhe financiare të burimeve të buxhetit të shtetit. Kështu, është detyrim ligjor, institucional dhe qytetar, të investohet pandërprerë në rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, me qëllim jo vetëm garantimin e përfshirjes sociale të grupeve më të rrezikuara, por edhe për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror e garantuar të drejtat themelore të qytetarëve për shërbime të mirëqenies shoqërore.

Në këtë kuadër, dhe në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030 dhe në vijim të Planit Social 2024-2027, bashkia Patos ka filluar punën për hartimin e Planit të ri Social 2025-2028. Procesi gjithëpërfshirës për hartimin e planit të ri social mbështetet në:

- ✓ Analizën e arritjeve të planit të mëparshëm si edhe në identifikimin e objektivave të parealizuara.
- ✓ Përcaktimin e shkaqeve dhe faktorëve që penguan arritjen e objektivave.
- ✓ Vlerësimin e mundësive për përfshirjen e objektivave të parealizuara në planin e ri.
- ✓ Vlerësimin e mundësive për përfshirjen e aktorëve të rinj, jo tradicionalë në organizimin, financimin, mbështetjen dhe sigurimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Hendeku ndërmjet nevojave për shërbime sociale dhe sistemi aktual i shërbimeve publike në nivel vendor është i njohur. Aktualisht ky hendek mbulohet deri në një farë shkalle nga organizatat jo-fitimprurese (OJF-të) operatorët privatë që ofrojnë shërbime sociale dhe organizatat fetare, të cilat të mbështetura nga organizmat ndërkombëtare dhe në një masë më të vogël nga buxheti i shtetit, ofrojnë shërbime për kategoritë në nevojë.

Plani i shërbimeve sociale të Bashkisë Patos bazohet në ofrimin e një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë, si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato vendore, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

2. Vlerësimi i arritjeve të Planit Social 2024-2027

Bashkia Patos ka qenë duke zbatuar Planin Social 2024-2027. Identifikimi i nevojave për shërbime të reja të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë Patos ka nxitur nevojën për të adresuar objektiva të tjerë dhe për të përshtatur prioritetet.

Ekipi i bashkisë Patos, i ngarkuar me detyrën e hartimit të Planit Social, vlerësoi shkallën e arritjes së objektivave të planit 2024-2027 nëpërmjet pyetësorëve të strukturuar drejtuar stafit teknik dhe përfaqësuesëve të institucione publike dhe jo publike që zbatojnë politika sociale, ofrues të shërbimeve sociale publike dhe jo publike, shoqata, organizata, grupe qytetarësh përfitues ose të përfshirë në shërbimet shoqërore.

Të dhënat u mbledhën gjatë periudhës Qershor 2025. Analiza e të dhënave tregoi se Objektivat Strategjike të Planit 2024-2027 janë realizuar pjesërisht, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore.

Plani Social 2024-2027 përbëhej nga tre objektiva strategjike:

Objektiv 1 : Zgjerimi dhe forcimi i sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki, i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, përkujdesit, integrimit dhe përfshirjes për të gjitha grupet në nevojë, të identifikuar dhe vlerësuara si të tilla, në përputhje me standartet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Realizimi: Ky objektiv është realizuar pjesërisht. Një nga arritjet më të mëdha mbetet “Rikonstrukcioni i Qendrës Multifunkionale të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror Bashkia Patos” dhe “Ngritje e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunkionale”.

Projekti u financuar nga Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim S.D.C, dhe është zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD), në kuadër të programit “LNB”2.

Përmes programit të Fondit Social të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Bashkia Patos u shpall fituese e projektit “Ngritje e shërbimit për funksionimin e qendrës multifunkionale” me vlerë 13, 008, 000 lekë dhe bashkëfinancim i Bashkisë Patos në vlerën 5, 540, 760 lekë për 36 muaj.

Qendra multifunkionale për shërbimet sociale drejtuar fëmijëve dhe të rinjve me aftësi ndryshe shërben si një qendër e kujdesit ditor për përfshirjen sociale të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi ndryshe të grupmoshës 3-21 vjeç.

Objektiv 2: Fuqizim të kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare, teknike të Bashkisë

Realizimi: Ky objektiv është realizuar pjesërisht.

Gjatë hartimit dhe zbatimit të planit struktura e shërbimit social ka qenë në nivel sektori, i cili kishte varësi direkte nga Drejtoria e Financës.

Në Janar 2025, me hyrjen në fuqi të strukturës së re, shërbimet sociale u integruan në nivel drejtorie në Drejtorinë e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit.

Stafi i Shërbimit Social dhe stafi i Qendrës Multifunkionale, përgjatë zbatimit të planit 2024-2027 ka përfituar rritje të kapaciteteve përmes trajnimeve të ndryshme, të dedikuara sipas funksioneve që mbulon secili punonjës, si për shërbimet që ofrohen, ndryshimet ligjore apo sisteme të ndryshme.

Objektiv 3: Krijimi e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t’u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e

tyre ekonomike, shoqërore, shëndetësore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.

Ky objektiv është realizuar në disa komponentë, duke u kujdesur që të rrisim aksesueshmërinë e përfituesëve të shërbimit në invetsimet e kryera, në ofrimin e shërbimit të përshtatur sipas kategorive, në parashikime buxhetore që të mbulojnë shërbime shoqërore shtesë për disa kategori dhe duke u anazhuar në projekte sociale për kategori të caktuara.

Faktorët themelorë pengues për realizimin e objektivave të mësipërm konsiderohen:

- ✓ Numri i ulët i shërbimeve të përkujdesit shoqëror
- ✓ Rritja e numrit të përfituesëve për disa kategori sociale
- ✓ Pamjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe financiare
- ✓ Mungesa e mbështetjes së bashkisë nga partnerët e saj.

Analiza e shkallës së realizimit të planit të mëparshëm tregoi gjithashtu se institucionet kanë qenë të përfshira edhe në hartimin edhe në zbatimin e planit social, Institucionet jo publike të kujdesit social, Drejtoritë Rajonale të Arsimit, Drejtorinë Rajonale të Shëndetësisë dhe Zyrën Rajonale të Shërbimit Social. Vihet re një mungesë e angazhimit të ofrimit të shërbimit nga organizata të shoqërisë civile.

Për shkak të shkallës së lartë të përfshirjes të strukturave më thelbësore, Plani Social 2024-2027 ka patur ndikim në ndërgjegjësimin e pushtetit vendor në domosdoshmërinë e rritjes së vëmëndjes ndaj të drejtave sociale të grupeve të përjashtuara, të cilët gjithashtu janë më të ndërgjegjësuara në raport me të drejtat e tyre. Ata njohin funksionimin e strukturave të mbrojtjes sociale dhe kërkojnë shërbimet që kanë nevojë, paralelisht me njohjen dhe vlerësimin e mbështetjes së siguruar nga pushteti vendor.

Pavarësisht arritjeve, ekipi i bashkisë është përballuar me sfida kritike përgjatë rrugëtimit 1.5 vjeçar të zbatimit të Planit Social. Konkretisht, çështjet më kritike konsiderohen:

- ✓ Buxhetet e kufizuara dhe mundësitë e kufizuara për gjetjen e burimeve alternative të financimit
- ✓ Papunësia e lartë dhe mundësitë e kufizuara të tregut të punës,
- ✓ Pikëpamjet, traditat, kultura e trajtimit të diskriminimit,
- ✓ Mungesa e projekteve të dedikuara për shërbimet sociale, të financuara nga donatorët.

3. Kuadri llogjik i Planit të Përkujdesit Social 2025-2028

3.1. Baza legjislative

Politikat lokale në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror burojnë nga politikat dhe standartet kombëtare për mbrojtjen shoqërore, të formuluar në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2024-2030, e cila pasqyron angazhimet e Qeverisë Shqiptare në fushën e Mbrojtjes Sociale duke synuar që t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore.

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale synon ndërtimin e një sistemi funksional të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqërore dhe komunitar në nivel vendor nëpërmjet:

- ✓ shtrirjes së Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Shërbimeve të Kujdesit Social në të gjithë territorin e Shqipërisë;
- ✓ ofrimit të shërbimeve shoqërore me bazë komunitare nga njësitë e qeverisjes vendore për të paktën tre kategori (personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në rrezik, të moshuarit dhe / ose grate); si edhe

- ✓ miratimit të planeve sociale vendore të shoqëruara me kosto dhe buxhete respektive nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social, strategjia e trajton ngushtësisht të lidhur me garantimin e qasjes së barabartë të çdo personi dhe familjeje shqiptare në nevojë dhe të përfitimit sipas nevojës të shërbimeve nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Bazuar në këtë Strategji, por edhe në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, sikurse në Ligjin nr.121, datë 21.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, bashkitë janë aktorët kryesorë në ngritjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel komunitar dhe si të tilla ato duhet të kenë kapacitetet e nevojshme veçanërisht në drejtim të planifikimit, organizimit, administrimit dhe kontrollit të këtyre shërbimeve.

Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 24 ka përcaktuar funksionet e Bashkisë në fushën e shërbimeve sociale dhe specifikisht: (1) Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. (2) Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. (3) Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. (4) Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Hartimi i Planit Social nga njësi e qeverisjes vendore është një detyrim që rrjedh nga neni 36 i Ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Paketa bazë e shërbimeve të kujdesit shoqëror që rrjedh nga ligji i sipërcituar i vjen në ndihmë bashkisë në procesin e planifikimit të shërbimeve sipas nevojave për mbrojtje dhe përkujdesje ndaj grupeve vulnerabël. Kjo paketë shërbimesh është konsoliduar përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”. Nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror identifikohen nga Bashkia përmes proceseve konsultuese dhe ato harmonizohen në Planin Social lokal, por shërbimet mund të ofrohen drejtpërdrejtë nga një ofrues publik (Bashkia, Qarku apo SHSSH) ose nga ofrues jopublikë. Bashkia duhet të drejtojë jo vetëm procesin e identifikimit të nevojave, por edhe koordinimin e kontributeve që mund të vijnë nga aktorë të ndryshëm publik e jopublik dhe reflektimin e tyre në këtë Plan.

Financimi i shërbimeve është parashikuar gjithashtu në ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe në pikën 2 të VKM nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”, sipas të cilit çdo Bashki ngre Fondin Social, i cili krijohet me burime financiare, nga: (a) fondet e kushtëzuara që akordohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale; (b) fondet nga buxhetet e njësive të vetëqeverisjes vendore, të parashikuara për shërbimet shoqërore; (c) të ardhurat nga organizatat jofitimprurëse, individët e bizneset, si dhe donatorë të huaj e lokalë; (ç) tarifatat për shërbimet për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Jo vetëm ligji, por edhe ky Vendim i Këshillit të Ministrave i sipërcituar kanë kushtëzuar financimin nga qeveria qendrore të shërbimeve komunitare të Bashkisë në kuadrin e hartimit dhe miratimit të Planit Social të saj.

Ndërkohë VKM 150, datë 20.03.2022 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, ka përcaktuar mekanizmin e financimit nga Qeveria qendrore, si dhe metodologjinë e përllogaritjes së fondeve që do të furnizojnë Fondin Social që ngre Bashkia.

Për të ngritur sisteme komunitare të qëndrueshme të kujdesit shoqëror është e domosdoshme që Bashkia të ndërtojë strukturat e duhura, të paisura me stafë të dedikuara në të dy nivelet e organizimit të saj.

Në përputhje me pikat 2 dhe 3 të nenit 36 të Ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror pranë bashkive ngrihen

struktura të posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe pranë çdo njësie administrative, në varësi të bashkisë, ngrihet njësia e vlerësimit të nevojave dhe referimit.

Në çdo njësi administrative në varësi të bashkisë, me përjashtim të bashkive me më pak së 6 mijë banorë, ngrihet Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit e cila, në këndvështrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duhet të ketë këto detyra kryesore:

- Identifikimin e rasteve të individëve dhe familjeve në nevojë.
- Vlerësimin fillestar të nevojave dhe të riskut për individët në nevojë.
- Informimin dhe këshillimin publik mbi të drejtat dhe mundësitë për kujdes dhe trajtim,
- këshillim për shërbimet shëndetësore dhe arsimore të mundshme në nivel vendor, këshillim për punësim, informim për pagesat sociale në të holla.
- ç) Hartimin e planit individual të përkujesit dhe mbështetjes.
- Bashkërendimin e mbështetjes për individët e familjet në nevojë, si dhe referimin te shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal e qendror, sipas fushës së përgjegjësisë dhe mundësisë për ta ofruar shërbimin e nevojshëm.
- dh) Përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për çdo individ për të përfituar nga shërbimet komunitare apo shërbimi rezidencial që përmbush nevojat e individit.
- Mbikëqyrjen në vazhdimësi të ecurisë së rasteve, si dhe vlerësimin për përshtatshmërinë e shërbimit të ofruar.
- ë) Hedhjen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të të dhënave përkatëse për njësinë administrative në varësi të bashkisë, sipas përcaktimit të Nenit 29, pika 2 të Ligjit 121/2016.
- Aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Për të realizuar funksionet e përcaktuara, Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit, duhet të ketë të paktën:

- a) një punonjës social të vlerësimit dhe referimit të rastit për çdo 6 000 deri në 10 000 banorë;
- b) një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për çdo 3 000 fëmijë;
- c) administrator shoqërorë.

3.1 Vizioni

Krijimi i mundësive për përdorimin e shërbimeve sociale cilësore për të gjithë qytetarët në nevojë në përputhje me nevojat e tyre në çdo njësi administrative të Bashkisë Patos.

3.2 Misioni

Garantimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror me cilësi të lartë në bashkëpunim me OJF-të dhe sektorin privat për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të të rriturve, të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi, duke siguruar mbrojtjen, përfshirjen dhe integrimin shoqëror të tyre.

3.3 Vlerat dhe parimet udhërrëfyese

3.3.1. Vlerat

Plani Social i Bashkisë Patos përgjatë realizimit të misionit do të ndihmojë në:

- ✓ Forcimin e kapaciteteve institucionale që ofrojnë shërbime të integruara dhe të veçanta për individë dhe grupe në nevojë kritike, si në komunitet ashtu dhe në familje;
- ✓ Sigurimin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit midis qeverisë qendrore, pushtetit vendor dhe rrjetit të organizatave jofitimprurëse;
- ✓ Rritjen e përgjegjësisë të pushtetit lokal për të mundësuar, mbështetur, mbrojtur dhe garantuar realizimin e të drejtave sociale të qytetarëve të bashkisë Patos, në radhë të parë, të atyre më të përjashtuar dhe në rrezik përjashtimi;

- ✓ Fuqizimin e institucioneve të pushtetit vendor, sidomos në drejtim të identifikimit të personave "në nevojë" ose "të rrezikuar" si dhe të vendimmarrjes mbështetur në parimin e interesit më të mirë të qytetarit dhe të respektimit të të drejtave sociale;
- ✓ Zbatimin e praktikave të mira dhe të modeleve të përparuara të financimit të shërbimeve sociale;
- ✓ Përdorimin me efektivitet të Fondit Social dhe përcaktimin e proceseve që garantojnë përdorimin e tij;
- ✓ Zgjerimin e rrjetit të bashkëpunëtorëve, në drejtim të përfshirjes dhe fuqizimit të bashkëpunimit me partnerë tradicionalë dhe jo tradicionale, duke synuar interesin më të mirë të qytetarit;
- ✓ Vëzhgimin/mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të miratuara të shërbimeve sociale, pavarësisht nga format dhe tipologjitë e shërbimeve.
- ✓ Rrjetëzim me institucione që zbatojnë praktika efektive

3.3.2. *Parimet udhëheqëse*

Hartimi i Planit Social të Bashkisë Patos udhëhiqet nga parimet që vijnë:

- ✓ Respektimi dhe garantimi i të drejtave për mbrojtje dhe siguri sociale në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni kombëtar;
- ✓ Nxitja e pjesëmarrjes të grupeve përfituese dhe grupeve të tjera të inetresit, përgjatë procesit të hartimit të planit si edhe të monitorimit të zbatimit të tij ;
- ✓ Fuqizimi në nivel personal dhe komunitar i individëve në nevojë, duke realizuar integrimin dhe përfshirjen e tyre në aktivitete ekonomike e sociale;
- ✓ Zbatimi i politikave lokale të mbështetura në parimet e mbrojtjes të inetresit më të mirë të fëmijës dhe të respektimit të barazisë gjinore ;
- ✓ Ndërtimi i politikave lokale në përputhje me kompetencat vendore që rrjedhin nga Ligji mbi Reformën Territoriale.
- ✓ Garantimi i aksesit të barabartë tek shërbimet e decentralizuara të shërbimeve shoqërore;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve shoqërore të ndërtuara mbi parimin e de-institucionalizimit;
- ✓ Ndërtimi i shërbimeve të qëndrueshme nga pikëpamja financiare dhe kosto-efektive.
- ✓ Krijimin e Fondit Social për financimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale.

3.3.3. *Synimet*

Qëllimi strategjik: Deri në vitin 2028, çdo person dhe familje në territorin e bashkisë Patos, kryesisht ata persona dhe familje të konsideruara në nevojë për shkak të përjashtimit shoqëror ose rrezikut të përjashtimit, do t'ju sigurohet mundësia e barabartë për të përfituar shërbime të përkujdesit shoqëror të cilësishme dhe në përputhje me nevojën e tyre, nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në një mjedis të shëndetshëm, nxitës dhe mbështetës të institucioneve dhe komuniteteve, të gatshme për të realizuar përgjegjësitë e tyre për realizimin e të drejtave sociale.

Objektivat:

Objektiv 1 : Përmirësim, zgjerim shërbimesh dhe forcimi i sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, përkujdesit, integritetit dhe përfshirjes për të gjitha grupet në nevojë, të identifikuar dhe vlerësuar si të tilla, në përputhje me standartet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Objektiv 2: Krijimi i një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e

tyre ekonomike, shoqërore, shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.

Objektiv 3: Fuqizim të kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare, teknike të Bashkisë

3.3.4 Analiza SWOT

Fuqi:

- ✓ Kërkesa për shërbime sociale është çështje emergjente sepse shërbimet mungojnë thuajse tërësisht, në veçanti për disa grupe kritike si individët me aftësi të kufizuara dhe invalidët e punës.
- ✓ Komunitetet e grupeve të përjashtuara janë të ndërgjegjshme për rolin e tyre si edhe të motivuara të marrin pjesë aktive në krijimin dhe forcimin e shërbimeve sociale.
- ✓ Bashkia Patos, ndonëse bashki e re, është e motivuar dhe e paisur me kapacitete njerëzore, teknike dhe profesionale, të përshtatshme për të ndërtuar dhe administruar shërbime cilësore sociale.
- ✓ Rritja e eksperiencës së stafit, eksperiencë e fituar kryesisht gjatë zbatimit të planit të mëparshëm social

Dobësi:

- ✓ Vështirësi në hartimin e projekteve dhe sigurimin e mbështetjes financiare.
- ✓ Mungesa e organizatave jo fitim-prurëse në territorin e Bashkisë.
- ✓ Ekspertizë e pamjaftueshme lokale në drejtim të ofrimit të shërbimeve, administrimit dhe monitorimit të tyre.
- ✓ Pavarësisht decentralizimit, lidhja dhe bashkëpunimi me Shërbimin Social Shtetëror, realizohet nëpërmjet qarkut Fier, jo drejtpërsëdrejti.

Mundësi:

- ✓ Reforma e Qeverisjes Vendore.
- ✓ Decentralizimi i shërbimi i sociale.
- ✓ Rritja e kompetencave të qeverisjes vendore dhe rritja e përpjekjeve për ndërgjegjësimin e tyre.
- ✓ Krijimi dhe forcimi i Fondit Social.
- ✓ Rritja e mundësive për aplikim për financime nga donatorët për shërbimet sociale.
- ✓ Vlerësimi me përparësi i zhvillimit të sistemit të shërbimeve sociale, nga qeveria.

Kufizime

- ✓ Mundësi të kufizuara të pjesëmarrjes të sektorit privat dhe sektorit jo fitim-prurës në mbështetjen e shërbimeve sociale në Patos.

4. Analiza e situatës

4.1. Të dhëna demografike

Të dhënat demografike janë të rëndësishme jo vetëm për të vlerësuar madhësinë e grupeve në nevojë për shërbime në raport me popullsinë e Bashkisë Patos, por edhe për të vlerësuar burimet njerëzore që duhet të ketë Bashkia në dy nivelet e organizimit (Bashki dhe njësi administrative) si detyrim që rrjedh nga legjislacioni kombëtar.

Sipas regjistrit të gjendjes civile, popullsia e bashkisë Patos, në territorin e riorganizuar në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, është 42.197 banorë (Tabela 1).

Tabela nr.1: Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimit mbështetur në të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile


Njësia Administrative	Numri i Popullsisë	Vendbanimi (persona)		Gjinia	
		Urban	Rural	Femra	Meshkuj
Patos	30.646	30.646		14.974	15.672
Zharrëz	8.810		8.810	4.236	4.574
Ruzhdie	3.241		3.241	1.503	1.738
Gjithsej	42.197	30.146	12.051	20.213	21.984

Burimi: Gjendja Civile, Qershor 2025.

Duke ju referuar treguesve të tjerë demografikë, konstatohet se:

- ✓ Bashkia Patos është kryesisht urbane, meqenëse 70% e popullsisë jeton në zonën urbane, ndërsa 30% e popullsisë jeton në zonën rurale.
- ✓ Shpërndarja sipas gjinisë është thujse e barabartë, me një përparësi të lehtë të gjinisë mashkullore (53%).


Figura 1 dëshmon se 70% e popullsisë jeton në qytetin e Patosit, ndërsa 75% në 10 njësitë e tjera administrative që përbëjnë bashkinë (Figura 1).



Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025.

Grup mosha 25 deri 64 vjeç përbën grupin më të konsiderueshëm (55%), por në krahasim me 5 vite më parë, përqindja e kësaj grup moshe ka rënie për shkak të lëvizjeve të fuqishme migratore. Grup mosha 0 deri 25 vjeç përbën 29% të popullsisë, tregues tepër domethënës për zhvillimin e forcave prodhuese dhe të punësimit. (Tabela 2 dhe Figura 2).

Figura 2: Popullsia sipas grupmohave



Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025.

Tabela 2: Popullsia sipas grupmohave

Njësia Administrative	Numri i Popullsisë	Popullsia sipas grupmohave		
		0-24 vjeç	25-65 vjeç	Mbi 65 vjeç
Patos	18.227	4,207	9,784	4,236
Zharrëz	4,061			915
Ruzhdië	1,911			401
Gjithsej	24.199			5,552

Burimi: INSTAT, 2025.

4.2. Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi

4.2.1. Përfituesit e Ndhmës ekonomike

Ndihma Ekonomike mbetet skema kryesore e mbështetjes sociale me vlerë monetare për familjet e varfëra në Shqipëri, ndërsa ka demonstruar një angazhim serioz në përmirësimin e efektivitetit, eficiencës dhe transparencës të programeve të asistencës sociale.

Strukturat përgjegjëse pranë Bashkisë Patos konfirmojnë se varfëria, mungesa e të ardhurave ose pamjaftueshmëria e tyre, janë shkaku themelor i përjashtimit shoqëror të familjes dhe individëve të saj. Në bashkinë e Patosit përfitojnë ndihmë ekonomike 131 familje ose 439 individë, 100% e aplikantëve që përbën 1.2% të popullsisë.

Tabela 3 ilustron përqindjen e përfituesve të ndihmës ekonomike në raport me popullsinë e bashkisë dhe të secilës njësi administrative. Siç vërehet, përfituesit e ndihmës ekonomike përbëjnë 1.2% të popullsisë së bashkisë, përkatesisht 0.6% të popullsisë në qytetin e Patosit

(përqindja më e ulët), ndërsa 5% në Ruzhdië (përqindja më e lartë). Siç mund të konfirmohet lehtësisht, përqindja e përfituesve të ndihmës ekonomike në krahasim me popullsinë është mjaft e ulët, ndërsa 100% e aplikantëve mbështeten ekonomikisht.

Programi i mbështetjes me ndihmë ekonomike, në situatën aktuale ka nevojë që të kalojë në një fazë të re reformimi që do të adresonte disa aspekte kritike të tilla si: përshtatshmëria dhe mjaftueshmëria, indeksimi, harmonizimi i përfitimeve me skemat e tjera si dhe ndërlidhja me shërbimet e tjera sociale

Faktorët që kushtëzojnë shkallën e ulët të mbështetjes me ndihmë ekonomike janë të ndryshëm. Shpjegimi më i dëshirueshëm lidhet me zhvillimin dhe punësimin në Patos për shkak të ndërmarrjeve dhe kompanive të lidhura me tregun e naftës. Sidoqoftë, ky shpjegim është deri diku në kontraditë me studimin mbi varfërinë dhe nivelin e jetesës, sipas të cilit rreth 3.600 individë konsiderohen nën nivelin e varfërisë (INSTAT, 2016). Për rrjedhojë, është e nevojshme që të hulumtohet më me kujdes situata ekonomike dhe sociale e popullsisë së Patosit.

Tabela 3: Individë përfitues të ndihmës ekonomike në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë si edhe me numrin e aplikantëve të NE, në përqindje.

Njësia Administrative	Popullsia	Aplikantë NE	Familje përfituese NE	Individë përfitues NE	% e përfituesve të NE ndaj popullsisë	% e përfituesve të NE ndaj aplikuesve
Patos	18.227	150	52	129	0.1%	100%
Zharrëz	4.061	80	23	78	2. %	100%
Ruzhdië	1.911	160	56	232	12.1%	100%
Gjithsej	24.199	390	131	439	14.2%	100%

Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2023

Tabela 4 ilustron përbërjen e përfituesve të ndihmës ekonomike. Vërehet se “fëmijë deri 16 vjeç” përbëjnë 40% të përfituesve të ndihmës ekonomike, Individët me AK, 4.5%, Gratë kryefamiljare 2.6%, Të moshuarit, 2% dhe Fëmijë me AK 1%.

Tabela 4: Përfituesit e ndihmës ekonomike, sipas përbërjes.

Njësia Administrative	Individë Përfitues	Fëmijë deri 16 vjeç	Të moshuar	Gra kryefamiljare	Individë AK	Fëmijë AK
Patos	129	27	4	7	6	0
Zharrëz	78	27	7	3	9	3
Ruzhdië	232	69	2	1	7	2
Gjithsej	439	123	23	11	22	5
Në përqindje	100	28%	5%	2,5%	5.1%	1%

Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025

Analiza statistikore vë në dukje se varfëria, duke gjykuar nga përqindja e familjeve përfituese të NE, është fenomen kryesisht “rural”, ndjekur më pas nga ai urban. Fëmijët zënë një peshë të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të anëtarëve të familjeve përfituese të NE, gjë e cila duhet të konsiderohet në hartimin e politikave lokale të mbështetjes nëpërmjet NE ose formave të tjera të shërbimeve sociale. Të moshuarit

gjithashtu përbëjnë një përqindje të konsiderueshme në numrin e përgjithshëm të familjeve përfituese të NE.

Familjet përfituese të NE kanë në përbërje të tyre individë me AK, gjë e cila e vështirëson situatën sociale dhe ekonomike të familjes, sidomos në raport me tregun e punës, duke zvogëluar mundësitë e punësimit, përfshirjes dhe integritetit të familjes. Një tjetër kategori që zë një peshë shumë të rëndësishme janë gratë kryefamiljare me persona të tjerë në ngarkim, kryesisht të mitur.

4.2.2. Aftësia e kufizuar

Programi i mbështetjes së aftësisë së kufizuar, gjatë viteve të fundit, ka kaluar në një proces reformimi.

Pavarësisht tendencës për të standardizuar dhe për të vendosur barazi në procesin e vlerësimit mes grupeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar, disa kategori të personave me aftësi të kufizuara nuk arritën t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit biopsikosocial, si: (i) përfituesit aktualë, por edhe aplikuesit e rinj që pretendojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e të verbërve ; (ii) përfituesit aktualë, por edhe aplikuesit e rinj që pretendojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e invalidit para-tetraplegjik dhe (iii) invalidët e punës që kërkojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e invalidëve të punës dhe që përfitojnë / aplikojnë për vlerësim në sistemin e Sigurimeve Shoqërore. Aftësia e kufizuar për tre grupet e sipërcituara përcaktohet përmes kriterëve, procedurave dhe strukturave të veçanta, të administruara nga Shërbimi Social Shtetëror dhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

2% e popullsisë në Bashkinë Patos (referuar të dhënave të bashkisë, Tabela 5) përfiton nga programi i pagesave monetare të aftësisë së kufizuar të financuar nga buxheti kombëtar. Nga 704 persona me AK, 15% janë fëmijë dhe 8 % janë të moshuar.

27% e personave me aftësi të kufizuar dhe 27% e fëmijëve me AK kanë një formë shumë të rëndë të aftësisë së kufizuar e për rrjedhojë kanë të drejtën e një kujdestari/ndihmësi me pagesë që kujdeset për ta.


Tabela 5: Individët me AK, sipas përbërjes dhe përfitimeve monetare.

Njësia Administrative	Popullsia	Individë AK		Fëmijë AK		Të moshuar AK Përfitojnë PAK
		Përfitojnë PAK	Përfitojnë pagesë kujdestarie	Përfitojnë PAK	Përfitojnë pagesë kujdestarie	
Patos	30.293	423	112	36	13	82
Zharrëz	8.755	205	39	26	6	46
Ruzhdië	3.217	76	16	6	1	1
Gjithsej	42.265	704	163	80	20	129
Në përqindje	100	2%	20%	12%	25%	18.5%

Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025

Rreth 73% e personave me aftësi të kufizuara banojnë në njësinë administrative Patos, 20% e tyre banojnë në njësinë administrative Zharrëz dhe 7% në Ruzhdië. (figura 3).

Aftësia e kufizuar është një faktorët më kritikë të përjashtimit shoqëror. Në Bashkinë Patos, personat me aftësi të kufizuar përjetojnë përjashtim të shumfishtë sepse përveç aftësisë së kufizuar, janë të përjashtuar nga tregu i punës si edhe nga mundësia për të siguruar një nivel të pranueshëm jetese.



Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025

Përveç aftësisë së kufizuar, grup që kërkon vëmendje është edhe grupi i invalidëve të punës. Tabela 6 paraqit të dhënat mbi numrin e përgjithshëm të invalidëve në secilën njësi dhe në bashki, si edhe përqindjen e tyre ndaj popullsisë. Siç tregon tabela 6, invalidët e punës përbëjnë 1.54 % të popullsisë.

Tabela 6: Invalidët e punës, numër dhe përqindje ndaj popullsisë.

Njësia Administrative	Popullsia	Invalidët e punës	
		Numër	Përqindje ndaj popullsisë
Patos	30.293	530	1,75%
Zharrëz	8.755	95	1,1%
Ruzhdië	3.217	25	0,7%
Gjithsej	42.265	650	
Në përqindje	100		1,54%

Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025

4.2.3. Punëkërkuesit e papunë

Janë gjithsej 614 punëkërkues të papunë në Bashkinë Patos. Papunësia në Patos ka profil krejtësisht urban dhe femëror, për arsye se tradicionalisht Patosi është qendër industriale, si edhe për arsye se banorët që posedojnë tokë nuk mund të konsiderohen të papunë. Vihet re se gratë përbëjnë mëse 60%

të të papunëve të regjistruar, nga të cilat 1/5 ose 20% janë kryefamiljare. Të rinjtë deri 25 vjeç përbëjnë grupin e dytë kryesor të të papunëve, 12%. 13% e të papunëve përfitojnë pagesë papunësie, ndërsa vetëm 2% e të papunëve përfitojnë nga programet e formimit profesional. (tabela 7).

Tabela 7: Të dhëna mbi punëkërkuesit e papunë, numër dhe përqindje.

Emërtimi	Njësia administrative	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Grupmosha			
					nën 30	30-39 vjeç	40-49 vjeç	mbi 50 vjeç
Nr i punëkërkuesve të papunë të regjistruar në ZP	Patos	614	406	208	85	76	83	370
	Zharrës	65	38	27	20	11	15	19
	Ruzhdie	13	8	5	4	4	3	2
Nr i punëkërkuesve të papunë të regjistruar të punësuar nga ZP	Patos	17	6	11	4	5	3	4
	Zharrës	5	3	2	1	2	2	0
	Ruzhdie	0	0	0	0	0	0	0
Nr i punëkërkuesve të papunë të regjistruar që kanë gjetur punë vet	Patos	44	26	18	15	20	5	4
	Zharrës	4	2	2	2	2	0	0
	Ruzhdie	1	1	0	1	0	0	0

Burimi: Zyra e Punës, Qershor 2025

4.2.4. Fëmijët e përjashtuar ose në rrezik përjashtimi

Hulumtimi i fëmijëve të përjashtuar dhe/ose në rrezik përjashtimi synon së pari të identifikojë grupet e fëmijëve në situatë më kritike duke i renditur sipas shkallës së prioritetit, mbështetur vetëm në treguesin sasior të përqindjes “fëmijë” në krahasim me totalin e grupit; së dyti, ri-renditjen e grupeve, duke konsideruar vlerësimin cilësor të nevojave të fëmijëve në raport me kriticitetin e situatës së tyre.

Tabela 8 paraqit përqindjen e fëmijëve të familjeve në NE dhe me AK kundrejt totalit të secilit grup dhe sipas njësive administrative të bashkisë Patos. Nga tabela konkludojmë se si pamjaftueshmëria e të ardhurave ashtu edhe AK janë dy probleme kritike që rëndojnë mbi fëmijët, meqenëse 40% e përfituesve të NE dhe 6% e individëve me AK, janë fëmijë.

Tabela 8: Fëmijë në situatë kritike për shkak të varfërisë dhe AK, në numër dhe përqindje, sipas grupeve dhe njësive administrative.

Njësia administrative	Ndihma Ekonomike	
-----------------------	------------------	--

				Aftësia e kufizuar		
	Persona gjithsej	Fëmijë	Në %	Persona gjithsej	Fëmijë	Në %
Patos	129	27	20%	915	48	5%
Zharrëz	78	27	34.6%	252	26	10%
Ruzhdie	232	69	29.7%	94	6	6%
Gjithsej	439	123	28.0%	1,261	80	6%

Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025

Me qëllim vlerësimin e përjashtimit tek fëmijët sipas treguesve sasiorë, ndërtojmë tabelën 9, në të cilën të tre kategoritë e fëmijëve në situatë kritike, për shkak të pamjaftueshmërisë të të ardhurave të familjes, për shkak të AK si edhe për shkak të nevojës për mbrojtje, paraqiten në përqindje sipas njësive dhe sipas popullsisë-“fëmijë deri 25 vjeç”.

Tabela 9 sjell një informacion tjetër të rëndësishëm, pasi pasqyron numrin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, sipas njësive administrative dhe në përqindje ndaj grupit të popullsisë, fëmijë. Në këtë tabelë duhej të pasqyrohej edhe numri i fëmijëve me probleme sociale të ndryshme. Por, siç vërehet, në Patos nuk identifikohet ansjë fëmijë në nevojë të veçantë apo rrezik përjashtimi për shkak të probleme sociale, përveç varfërisë dhe aftësisë së kufizuar, për rrjedhojë kolona e parë dhe e tretë e tabelës 9 paraqisin të njëjtin numër fëmijësh.

Siç konfirmon kjo tabelë, rreth 2.5% e fëmijëve janë në nevojë për mbrojtje, një përqindje kjo relativisht e ulët, krahasuar me mesataren e vendit apo edhe të qarkut Fier. Tejet kritike paraqitet situata në Ruzhdie, ku kjo përqindje është disa here më e lartë se sa mesatarja e bashkisë.

Tabela 9: Fëmijë në nevojë për mbrojtje

Njësia administrative	Fëmijë gjithsej	Fëmijë të familjeve NE dhe me AK	Fëmijë pa kujdes prindëror të përkohshëm	Fëmijë në nevojë për mbrojtje gjithsej	Në % ndaj grupit “Fëmijë”
Patos	3.446	53	0	53	5.96%
Zharrëz	620	37	0	37	5.96%
Ruzhdie	384	74	0	74	19.2%
Gjithsej	4450	164	0	164	3.6%

Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025

Tabela 9, përveç informacionit sasior, nxjerr në pah një kontraditë tejet të rëndësishme në lidhje me mundësitë e identifikimit të fëmijëve në situatë kritike. Ndërsa të dhënat mbi fëmijët e familjeve në NE dhe fëmijëve me AK janë të plota, të dhënat mbi fëmijët në rrezik përjashtimi për arsye të tjera, përveç pamjaftueshmërisë të të ardhurave dhe AK, janë shumë më modeste. Siç vërehet, numri i rasteve të menaxhuara të fëmijëve në nevojë është zero. Sidoqoftë, kjo nuk dëshmon për mungesën e rasteve të fëmijëve në nevojë, por për mungesën e kapaciteteve të trajtimit të rasteve të fëmijëve në nevojë, e cila nuk kushtëzohet vetëm nga krijimi i NjMF, por çka është më thelbësore, duhet të krijohen dhe funksionojnë shërbimet me bazë komunitare, si edhe duhet të investohet në rritjen e kapaciteteve profesionale të qeverisjes vendore.

4.2.5. Gra në situatë kritike

Me qëllim evidentimin e kategorive të grave më të përjashtuara si edhe arsyet e përjashtimit, është ndërtuar Tabela 10, e cila paraqit informacion sasior të përmbledhur, mbi numrin e grave kryefamiljare në familjet përfituese të NE, numrin e grave viktime të dhunës në familje si edhe numrin e punëkërkueseve gra. Numri i punëkërkueseve gra për efekt të ndërtimit të tabelës 10 dhe të eliminimit të rrezikut të paraqitjes së informacionit artificialisht të rritur, është llogaritur si diferencë e numrit të punëkërkueseve të paraqitur në tabelën 7 me numrin e grave kryefamiljare, përfituese të NE të tabelës 5, sepse gratë kryefamiljare, përfituese të NE janë të papuna.

Tabela 10 dëshmon se 2.3% e grave në bashkinë Patos përjetojnë situatë kritike përjashtimi për shkak të pamjaftueshmërisë të të ardhurave ose arsyeve të tjera. Nëse kjo e dhënë do të pasqyronte realitetin, sigurisht që do të përbënte një arritje të politikave sociale të zhvillimit të bashkisë. Por, ka shumë pak të ngjarë që kjo e dhënë të pasqyrojë faktin e mirëqenies të grave në bashkinë Patos, sepse kundërshtohet nga të dhëna të tjera, të trajtuara më lart dhe në vijim, tek kapitulli I profilit të shërbimeve sociale të bashkisë.

Tabela 10: Numri i grave në situatë kritike

Njësia administrative	Gra gjithsej	Gra kryefamiljare Përfituese NE	Gra të shfrytëzuara /të dhunuara	Punë kërkuese të papuna	Gjithsej	Në %
Patos	9042	7	14	406	427	4.7%
Zharrëz	1977	3	3	38	44	2.2%
Ruzhdië	954	1	0	8	9	0.94%
Gjithsej	11.973	11	17	452	480	4%

Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025

Tabela 10, sikundër në rastin e interpretimit të kontraditës për informacionin e tabelës 9, nuk dëshmon për mungesën e rasteve të grave në nevojë, por për mungesën e kapaciteteve të trajtimit të rasteve të grave në nevojë, si edhe për shkallën ende të ulët të ndërgjegjësimit të shoqërisë shqiptare për të vetëidentifikuar rastet ose për të reaguar ndaj rasteve. Pavarësisht nevojës të krijimit dhe forcimit të strukturave përgjegjëse për trajtimin e dhunës në familje apo edhe situatë të tjera kritike, mbetet tejet thelbësor nevoja për krijimin dhe funksionimin e shërbimeve me bazë komunitare, si edhe investimi në zhvillimin dhe edukimin e shoqërisë dhe komunitetit, ku lind, ushqehet dhe rritet familja shqiptare.

4.2.6. Të moshuar në situatë kritike

Miratimi i Dokumentit Politik të Moshimit dhe Planit të Veprimit 2025-2030 Analiza e situatës të të moshuarve synon të ofrojë një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për përmirësimin e cilësisë së ëjetës së të moshuarëve në Shqipëri.

Aktualisht Shqipëria po përballlet me sfida të thella demografike dhe ekonomike, q ëndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e të moshuarëve.

Tabela 11 paraqit përqindjen e të moshuarve në situatë të pamjaftueshmërisë të të ardhurave në secilën njësi administrative të bashkisë. Sipas të dhënave të tabelës 11, mungesa e pensionit, karakteristikë për të moshuarit e zones rurale, është faktori kryesor me natyrë monetare, I përjashtimit të të moshuarve. Siç vërehet, rreth 9% e të moshuarve jetojnë në kushte kritike. Një pjesë fare e vogël, 0.1% dhe 0.7% përfitojnë NE dhe PAK, ndërsa pjesë tjetër përjeton vështirësitë ekonomike e sociale që rrjedhin nga pamjaftueshmëria e të ardhurave.

Tabela11: Përqindja e të moshuarve në situatë të pamjaftueshmërisë të të ardhurave.

Njësia administrative	Popullsia mbi 65 vjeç	Të moshuar në kushte kritike				Në %
		Nën nivelin e varfërisë	Familje NE	AK	Gjithsej	
Patos	5.149	523	3	6	532	10
Zharrëz	1.488	74	7	46	127	8.5
Ruzhdië	547	19	0	1	20	3.6
Gjithsej	7.184	616	10	53	679	9.4
Në përqindje	100	8.6	0.1	0.7	9.4	

Burimi: Bashkia Patos 2025

4.2.7.Minoritetet etnike

Komunitetet etnike Romë dhe Egjiptianë janë mjaft të kufizuar në numër në bashkinë Patos. Nuk ka evidenca për individë të cilët janë në nevojë për shërbime dhe nuk i përfitojnë ato.

4.2.8.Të pastrehë

Në tërëtorin e Bashkisë Patos familjet e pastreha nuk përbëjnë një përqindje kritike, sepse në sajë të përpjekjeve të bashkisë, pjesa më e madhe janë strehuar dhe/ose kanë përfituar bonus qeraje. Konkretisht familje gjithsej janë strehuar në banesa sociale, pronë e bashkisë Patos, ndërsa 2 familje kanë përfituar bonus qeraje.

4.3. Profili i shërbimeve që ofrohen në bashkinë Patos

4.3.1. Shërbimet dhe institucionet e përkujdesit shoqëror

Në bashkinë Patos funksionon vetëm një shërbim i përkujdesit shoqëror, i financimit të përzier, në ambjentet e Qendrës Multifunktionale.

Qendra po zbaton projektin “Ngritja e Shërbimit për funksionimin e Qendrës Multifunktionale” që prej vitit 2024 të financuar nga Fondi Social, me një staf prej 5 personash, 1 menaxhere projekti, 1 punonjëse sociale, 2 psikologe dhe 1 sanitare.

Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i cilësisë së jetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të shërbimit psiko-social dhe terapeutik në qendër. Target grupi i synuar janë 40 fëmijë me AK. Përmes këtij shërbimi synohet aftësimi me qëllim rritjen e potencialit të fëmijës si dhe integrimi në jetën shoqërore.


4.3.3.Burimet njerëzore, ofruese të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Spektori Shërbimit Social, në varësi të Drejtorisë së Mbrojtjes Socioale dhe Politikave të Arsimit ka 3 punonjës që sigurojnë funksionimin e sistemit të përkujdesit shoqëror në bashkinë Patos, duke ofruar përfitime monetare dhe shërbime ndaj qytetarëve në nevojë. I gjithë stafi është me arsim të lartë dhe pas universitar. Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit nuk është krijuar ende, ndërsa të gjitha

strukturat e tjera, krijimi i të cilave është detyrim ligjor, duhet të plotësohen me staf që të funksionojnë me efikasitet. Regjistri elektronik gjithashtu nuk është populluar ende me të dhëna, për rrjedhojë, ende nuk përdoret, përfundimisht çështja e plotësimit të nevojave me staf të kualifikuar është dhe mbetet problem kritik.

Figura 5 ilustron treguesin e përfituesve mesatarisht për 1 punonjës të shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Vërejmë se ndërsa 1 punonjës i institucioneve mesatarisht duhet të kujdeset për 15 individë në nevojë, 1 punonjës i bashkisë dhe institucioneve duhet të kujdeset për 171 persona në nevojë, nëse konsiderojmë të gjithë ata që i drejtohen bashkisë për ndihmë dhe mbështetje, dmth nëse përfshijmë edhe pagesat monetare. Treguesi i dytë është relativisht i lartë, duke konsideruar jo vetëm nivelin e kërkesës në aspektin sasior por edhe detyrimin për të realizuar standartet e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit.

Megjithatë edhe fakti që treguesi i numrit mesatar të përfituesve për 1 staf është i ulët, nuk tregon domosdoshmërisht cilësi shërbimi. Sigurisht, për ato institucione ku ofrohet shërbim, ky tregues të udhëheq drejt gjyqimit që cilësia e shërbimit të sigurohet ndaj përfituesve I ka të gjitha mundësitë që të jetë e lartë. Por vetëm fakti i ekzistencës të kaq pak institucioneve dhe të një numri kaq të ulët të përfituesve të shërbimeve (gjithsej 30) në një bashki me rreth 40,000 banorë, është shumë më domethënëse se sa Numri mesatar I përfituesve për staf.



Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025

3

Çështja e mungesave të stafit nga pjesëmarrësit në procesin e vlerësimit të planit të mëparshëm social dhe arritjeve të tij, konsiderohet si një nga faktorët themelorë që kanë ndikuar në arritjen e pjesshme të objektivave. Për më tej, mbështetur në legjislacionin ekzistues mbi strukturat e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit duhet të ketë 1 punonjës për 6.000 banorë, ndërsa Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve duhet të ketë 1 punonjës për 3.000. Për rrjedhojë, nevoja për staf dhe kualifikim të mëtijshëm është e evidente. Plani Social evidendon me saktësi nevojat edhe në këtë drejtim, përgjatë përpunimit të komponentit të burimeve njerëzore, institucionale e financiare në funksion të realizimit të objektivave të planit.

4.4. Përmbledhje: Grupet e përjashtuara ose në rrezik përjashtimi

Për të llogaritur individët në nevojë në bashkinë Patos përdoren të gjitha të dhënat e paraqitura në tabelat nga 1 deri 11. Rezultatet e përmbledhura paraqiten në vijim, tek Tabela 13. Për të ndërtuar

tabelën 13, si përmbledhje të të gjitha grupeve të analizuara, u ndërmorën disa veprime me qëllim që të dhënat të pasqyrojnë situatën reale. Kështu:

- ✓ Për të llogaritur Individë në nevojë, nga numri i përgjithshëm i aplikuesve të NE, u hoqën fëmijët, të moshuarit, gratë e vetme, individët me AK.
- ✓ Për të llogaritur individët AK, nga numri i përgjithshëm, u hoqën fëmijët me AK dhe të moshuarit.
- ✓ Grupet Gra, Fëmijë dhe të Moshuar në situatë kritike u llogaritën veçmas më lart.
- ✓ Tek grupi të “Papunë” zbriten gratë e papuna, të rinjtë dhe egjiptianët, sepse secila nga këto kategori është grup social i veçantë.

Tabela 13: Individë në situatë kritike dhe në nevojë për shërbime

Njësia administrative	INDIVIDË NË SITUATË KRITIKE									
	Përfitues NE	AK dhe Invalidë pune	Fëmijë	Gra	Të moshuar	Të papunë	Romë Egjiptianë	Të pastrehë	Të rinj të papunë	Gjithsej
Patos	98	860	114	338	532	276	5	24	85	2.332
Zharrëz	126	292	68	97	127					710
Ruzhdie	50	121	110	35	20			4		340
Gjithsej	274	1.273	292	470	679	276	5	28	85	3.382
Në përqindje	8%	39%	9%	14%	21%	8%	0.1%	0.8%	2.5%	100%
Përfitojnë shërbime aktualisht		150 ¹								150
Në % ndaj numrit të përgjithshëm të individëve në nevojë		11.7%								4.4%
Individë në nevojë për shërbime	274	1.273	292	470	679	276	5	28	85	3.352
Në %	8	38	7.8	14	20	8	0.1	0.8	2.5	100

Burimi: Bashkia Patos, 2025

Analiza e grupeve në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, identifikoi faktin se në territorin e Bashkisë Patos janë 3.382 individë, që kanë të nevojshëm të paktën një formë të shërbimeve të kujdesit shoqëror.


Individët me AK dhe Invalidët përbëjnë grupin më kritik në raport me nevojën për shërbime, 38%; pasuar nga “Të moshuarit”, 20%; Gratë, 14%; Fëmijët, 8%, Përfituesit e NE dhe të Papunët, 8%; të Rinjtë, 2.5%, të Pastrehët, 0.8% dhe së fundmi, Minoritetet etnike 0.1%.

Tabela 14: Përmbledhje e individëve në nevojë për shërbime të identifikuara në raport me numrin e popullsisë

NJËSIA ADMINISTRATIVE	NR.POPULLSIE	NR. INDIVIDË NË NEVOJË SHËRBIME KUJDESI SHOQEROR PËR	%
Patos	30,293	2.302	7.6%
Zharrez	8,755	710	8.1%
Ruzhdie	3,217	340	10.5%
Gjithsej	42,265	3.352	8%

Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025.

Siç tregon tabela 8% e popullsisë është në nevojë për shërbime. Mbështetur në të dhënat e tabelës, është ndërtuar figura 11, e cila dëshmon se përqindja e personave në nevojë në 1 njësi administrative, në Ruzhdie është më e madhe se sa mesatarja e bashkisë.



Burimi: Bashkia Patos, Qershor 2025

E gjithë analiza dukshëm argumenton renditjen si vijon të grupeve mbështetur në analizën sasiore të të dhënave:

1. Individë me AK dhe Invalidë pune
2. Të moshuar
3. Gra në nevojë
4. Fëmijë në nevojë për mbrojtje
5. Përfitues NE
6. Të papunë
7. Të rinj të papunë
8. Të pastrehë
9. Romë dhe Egjyptianë

Diskutimet e zhvilluara në bashki me grupet e interesit, pjesë e vlerësimit të situatës sipas treguesve cilësorë, argumentuan nevojën për të trajtuar grupet sipas prioriteteve në vijim, përkatësisht:

Alternativa B:

1. Fëmijët
2. Të moshuarit
3. Gratë
4. Të rinjtë
5. Qytetarët në moshë pune
6. Minoritetet etnike
7. Migrantët e kthyer

Analiza e shërbimeve të kujdesit shoqëror konkludoi në mungesën e plotë të shërbimeve për çdo grup, me përjashtim të një shërbimi tepër modest për fëmijë me aftësi të kufizuar. Kështu që, vetëm Alternativa A dhe B shërbejnë për të ndërtuar listën e grupeve sipas prioriteteve.

Të dy alternativat nuk janë plotësisht të përpuethshme me njera tjetrën sepse janë ndërtuar ose me metoda sasiore ose me metoda cilësore. Arsyeja e mospërputhjes të plotë të të dhënave sasiore dhe cilësore është rrjedhojë e dy faktorëve themelorë:

- A. Analiza cilësore përqëndrohet kryesisht në identifikimin e shërbimeve të munguara, ndërsa analiza sasiore mbështetet tek të dhënat e grupeve që aktualisht përfitojnë shërbime.
- B. As analiza sasiore, as analiza cilësore nuk mbështeten në studim të mirfilltë shkencor të situatës dhe të vlerësimit të nevojave, problem i adresuar me forcë nga punonjësit e bashkisë.
- C. Analiza sasiore mbështetet kryesisht në të dhëna të programeve sociale që sigurojnë përfitime monetare.

Për rrjedhojë, Plani Social do të adresojë nevojat e grupeve më të përjashtuara duke konsideruar ndërtimin e një alternative të tretë, të mbështetur në një sistem të pikëzuar, që I rendit grupet si vijon:

1. Individë me AK dhe Invalidë pune
2. Fëmijë në situatë kritike
3. Të moshuar
4. Gra në situatë kritike
5. Individë në nevojë ekonomike
6. Të rinj në situatë kritike

Duke ju referuar shportës së shërbimeve shërbimeve të kujdesit shoqëror në përputhje me ligjin 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”², nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror prezantohen në tabelën 16.

Tabela 16. Individët në nevojë dhe tipet e shërbimeve të mundshme sipas shportës së shërbimeve

INDIVIDË NË NEVOJË PËR SHËRBIME	BASHKIA	TIPET E SHËRBIMEVE SIPAS SHPORTËS
Persona me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç dhe invalidë pune	1.354	1. <i>Shërbime rehabilituese</i> per personat në nevojë për aftësim fizik; 2. <i>Shërbimet në familje</i> për persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare dhe që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal; 3. <i>Shërbimi i strehimit të mbrojtur</i> per personat me aftësi të kufizuara, të cilët nuk kanë një strehë.
Fëmijë në situatë kritike në nevojë për mbrojtje	40	1. <i>Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line</i>, shërbim i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës 2. <i>Shërbimi i përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror, për zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës</i> kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislationit në fuqi. 3. <i>Qendrat ditore për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike;</i> 4. <i>Qendrat ditore për fëmijë me aftësi të kufizuara;</i> 5. <i>Shërbime zhvilluese dhe rehabilituese</i> për fëmijë me çrregullime të zhvillimit; me prapambetje mendore; me çrregullime në komunikim; në nevojë për aftësim fizik; 6. <i>Shërbimi i emergjencës 72 orë</i> për fëmijët pa kujdes prindëror ose të dhunuar, fëmijë të rrugës, të shfrytëzuar, të abuzuar dhe fëmijë me aftësi të kufizuara.
Moshuar	700	1. <i>Shërbimet në familje</i> për të moshuar të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale, të cilët e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal.

		2. Qendra ditore për të moshuarit;
Gra në nevojë për mbrojtje	17	1. Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line, shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës, për mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; 2. Shërbimi i emergjencës 72 orë për viktima të dhunës në familje dhe fëmijët që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. 3. Shërbimi i strehimit të mbrojtur për viktimat e dhunës në familje, viktimave të trafikimit të cilët nuk kanë një strehë.
Individë mbi 18 vjeç përfitues të ndihmës ekonomike	316	1. Program për fuqizimin ekonomik. 2. Informimi dhe këshillimi për punësim për përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshatshme për nevojat e tij.
Punëkërkes	452	1. Program për fuqizimin ekonomik, punësim, sipërmarrje dhe vetëpunësim. 2. Informimi dhe këshillimi për punësim për përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshatshme për nevojat e tij. 3. Program për formim dhe riformim profesional.
Të rinj në rrezik përjashtimi	90	1. Program për fuqizimin ekonomik, punësim, sipërmarrje dhe vetëpunësim. 2. Informimi dhe këshillimi për punësim për përmirësimin e situatës së individit, duke e orientuar rreth mundësive më të përshatshme për nevojat e tij. 3. Program për nxitje arsimimi. 4. Program për integrim social.

5. Fushat strategjike në të cilat duhet të ndërhyjë bashkia nëpërmjet Planit Social 2025-2028

5.1. Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi strategjik: Deri në vitin 2028, çdo person dhe familje në territorin e bashkisë Patos, kryesisht ata persona dhe familje të konsideruara në nevojë për shkak të përjashtimit shoqëror ose rrezikut të përjashtimit, do t'ju sigurohet mundësia e barabartë për të përfituar shërbime të perkujdesit shoqëror të cilësishme dhe në përputhje me nevojën e tyre, nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në një mjedis të shëndetshëm, nxitës dhe mbështetës të institucioneve dhe komuniteteve, të gatshme për të realizuar përgjegjësitë e tyre për realizimin e të drejtave sociale.

Objektivat:

Objektiv 1 : Përmirësim, zgjerim shërbimesh dhe forcimi i sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, perkujdesit, integritit dhe përfshirjes për të gjitha grupet në nevojë, të identifikuar dhe vlerësuar si të tilla, në përputhje me standartet kombëtare të shërbimeve të perkujdesit shoqëror.

Objektiv 2: Krijimi i një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.

Objektiv 3: Fuqizim të kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare, teknike të Bashkisë

Kosto e përgjithshme e Planit të Shërbimeve Sociale, 2025-2028

Objektivat dhe objektivat specifike	Kosto e përgjithshme	Periudha/Viti			
		2025*	2026	2027	2028
Objektiv 1	59,800,000		4,800,000	27,500,000	27,500,000
Obj.Specifik 1.1	14,000,000		2,000,000	6,000,000	6,000,000
Obj.Specifik 1.2	33,000,000		1,000,000	16,000,000	16,000,000
Obj.Specifik 1.3	6,000,000			3,000,000	3,000,000
Obj.Specifik 1.4	6,800,000		1,800,000	2,500,000	2,500,000
Objektiv 2	1,650,000		630,000	630,000	390,000
Obj.Specifik 2.1	860,000		340,000	340,000	180,000

Obj.Specifik 2.2	630,000		210,000	210,000	210,000
Obj.Specifik 2.3	160,000		80,000	80,000	
Objektiv 3	7,060,000		2,740,000	2,160,000	2,160,000
Obj.Specifik 3.1	5,400,00		1,800,000	1,800,000	1,800,000
Obj.Specifik 3.2	1,080,000		360,000	360,000	360,000
Obj.Specifik 3.3	580,000		580,000		
Gjithsej	68,510,000		8,170,000	30,290,000	30,050,000

*Për vitin 2025 nuk janë parashikuar shpenzime finnaciare.

5.2. Plani i veprimit

Qëllimi strategjik: Deri në vitin 2028, çdo person dhe familje në territorin e bashkisë Patos, kryesisht ata persona dhe familje të konsideruara në nevojë për shkak të përjashtimit shoqëror ose rrezikut të përjashtimit, do t'ju sigurohet mundësia e barabartë për të përfutur shërbime të përkujdesit shoqëror të cilësishme dhe në përputhje me nevojën e tyre, nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitutionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, në një mjedis të shëndetshëm, nxitës dhe mbështetës të institucioneve dhe komuniteteve, të gatshme për të realizuar përgjegjësitë e tyre për realizimin e të drejtave sociale.

Objektivat:

Objektiv 1 : Përmirësim, zgjerim shërbimesh dhe forcimi i sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, përkujdesit, integritetit dhe përfshirjes për të gjitha grupet në nevojë, të identifikuar dhe vlerësuara si të tilla, në përputhje me standardet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.

Kosto e përgjithshme e Objektivit 1 : 59,800,000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	BAZA LIGJORE	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO
Objekti specifik 1.1: Vijim i ofrimit të shërbimit për funksionimin e Qendrës Multifunkionale, duke shtuar shërbime të tjera si logopedia, fizioterapia etj.					
Përfutjes: Fëmijë me aftësi të kufizuara 6-21 vjeç, deri në 30-40 përfutjes.					
Kapaciteti i qendrës: 50 deri 60 përfutjes në ditë, të organizuar në dy turne.					
Modeli: Qendra Multifunkionale					
Shërbimet: terapi zhvillimi, edukimi, logopedi, fizioterapi terapi individuale, terapi në grup bazuar mbi parimet e terapisë së sjelljes.					

shërbime me fokus autonominë dhe higjienë personale, aktivitete socializimi dhe rekreative-kulturne, informim, fuqizim dhe ndërgjegjësim për personat me aftësi të kufizuara, familjarët e tyre dhe komunitetin, avokati, lobim, rrjetëzim. Shërbim i veçantë: Rehabilitim për fëmijë me aftësi të kufizuara, rreth 12 fëmijë në ditë, në 3 grupe nga 4 fëmijë.						
Kosto e përgjithshme e Objektivit Specifik 1.2: Lekë 33,000,000 (për periudhën 2024 -2027)						
1.1.1. Identifikimi i personave që kanë nevojë për shërbim në familje	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore	3 muji I, 2026		Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit ”.	Bashkia Të ardhura të vetat. Bashkia Fondet e Pakushtëz uara Bashkia Fondi Social Donatorë të huaj(UND P, BE, UNICEF) Burime financimi në përputhje me aplikime të hapura	Pa kosto
1.1.2. Hartimi i praktikave të shërbimit dhe manualeve përkatës	Grup ekspertësh të përzgjedhur nga Bashkia/Donatori	3 muji II, 2026				Grup ekspertësh (2) për 25 ditë 2*25 ditë*Lekë10.000/ditë Lekë 500,000
1.1.3. Përzgjedhja e një ekipi prej 10 punonjësish socialë të cilët do të ofrojnë me kohë të pjesëshme shërbime në familje (10 persona, secili përgjegjës për 25 individë me AK)	Bashkia	3 muji II, 2026				Pa kosto
1.1.4. Kualifikimi i stafit	Grup ekspertësh të përzgjedhur nga Bashkia/Donatori	3muji III, 2026				Grup ekspertësh (2) për 25 ditë 2*25 ditë*Lekë10.000/ditë Lekë 500,000
1.1.5. Sigurimi i ambientit	Bashkia	6 muji I,				Shpenzim investimi I njëhershëm: 1,000,000 lekë

përshatshëm të punës për ekipin e punonjësve socialë si edhe të paisjeve të nevojshme	2026				10 persona*12 muaj*50,000 lekë/muaj=6,000,000 në vit 12,000,000 është buxheti I duhur për të gjithë periudhën.
1.1.6.Sigurimi i mbështetjes financiare për funksionimin e shërbimit	Këshilli Bashkiak	PBA 2026-2028			
Objektivi specifik 1.2: Sigurim shërbime sociale për “Individë mbi 18 vjeç me AK dhe Invalidët” nëpërmjet ofrimit të “Shërbimeve në familje” (për persona që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal). Përfutjes: Individë me AK: Ndonëse të dhënat dëshmojnë 1.273 persona gjithsej, vetëm një pjesë e tyre do të kenë nevojë për shërbime në familje, afërsisht kjo llogaritet për rreth 25%, dmth 300 persona. Kosto e përgjithshme e Objektivit Specifik 1.1: Lekë 14,000,000 (për periudhën 2025-2028).					
1.2.1. Identifikimi i terrenit apo objektit për ndërtimin apo transformimin në qendër multifunksionale komunitare	Drejtoria e NE dhe NjMF	3 mujori I, 2026	Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, “Statusi i invalidit”.	Bashkia: Të ardhura të vetat. Bashkia: Fondet e Pakushtëz uara	Pa kosto
1.2.2. Realizimi i	Bashkia	Deri në	Ligj Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe	Bashkia:	Kosto variable në varësi të

punimeve të infrastrukturës		fund të vitit 2026	Mbrojtjen e Fëmijës” Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit” Ligji 22/2018 “Për strehimin social” Ligji 47/2018 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”	Fondi Social	opsioneve.
1.2.3. Përzgjedhja e stafit përgjegjës për funksionimin e qendrës	Bashkia	3 muhori III, 2026		Donatorë të huaj(UND P, BE, UNICEF)	Pa kosto
1.2.4. Ndërtimi i praktikave të shërbimeve	Grup ekspertësh	3 muhori III, 2026		Burime financimi në përputhje me aplikime të hapura	Grup ekspertësh (2) për 25 ditë 2*25 ditë*Lekë10000/ditë Lekë 500,000 3 muhori 3 Kosto e përfshirë tek 1.4.
1.2.5. Hartimi i manualeve të shërbimeve	Grup ekspertësh	3 muhori III, 2026			
1.2.6.Kualifikimi i stafit	Grup ekspertësh I përzgjedhur nga Bashkia/donatori (në rast se shërbimi do të ngrihet me mbështetjen e donatorit)	3 muhori IV, 2027			Grup ekspertësh (2) për 10 ditë 2*10 ditë*Lekë25,000 ditë Lekë 500,000
1.2.7.Mbështetja financiare dhe teknike për funksionimin operacional të qendrës	Këshilli Bashkiak	PBA 2026-2028			Kosto operacionale e qendrës:16 milion lekë në vit Personel: 10 vetë Për të gjithë periudhën: 32,000,0000

Objektivi specifik 1.3: Sigurim shërbime sociale për të moshuar nëpërmjet ofrimit të “Shërbimeve në familje” (për persona që e kanë të pamundur të kujdesen për veten dhe nuk mund të ndihmohen nga familjarët apo kujdestari /ndihmësi personal). Përfutjes: Të moshuar. Ndonëse të dhënat dëshmojnë 679 të moshuar, vetëm një pjesë e tyre do të kenë nevojë për shërbime në familje, afërsisht kjo llogaritet për rreth 20%, dmth 125 persona Kosto e përgjithshme e Objektivit Specifik 1.3: Lekë 6,000,000 (për periudhën 2026-2028).					
1.3.1. Identifikimi I personave që kanë nevojë për shërbim në familje	Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore	3mujori I, 2026			Njëlloj si objektivi specifik 1.1. Pa kosto
1.3.2. Hartimi i praktikave të shërbimit dhe manualeve përkatës	Grup ekspertësh të përzgjedhur nga Bashkia/Dona tori	3 mujori II, 2026			Pa kosto
1.3.3. Përzgjedhja e një ekipi prej 5 punonjësish socialë të cilët do të ofrojnë me kohë të pjesshme shërbime në familje (5 persona, secili përgjegjës për 25 të moshuar) dhe ofrimi I shërbimit.	Bashkia	3 mujori II, 2026			5 persona*12 muaj*50,000 lekë/muaj=3,000,000 në vit Buxheti për të gjithë periudhën 6,000,000 lekë.
Objektivi specifik 1.4: Sigurim shërbime të nxijes të punësimit dhe vetëpunësimit, formimit profesional, sipërmarrjes dhe fuqizimit ekonomik.					

përfutues: 470 gra, kryefamiliares dhe përfutueses të NE, të papuna, viktime të dhunës, në situatë të vështirë ekonomike dhe sociale					
274 individë të tjerë, përfutues të NE					
276 punëkërkes të papunë					
85 të rinj të papunë, në rrezik përjashtimi, në konflikt me ligjin, në nevojë për mbrojtje dhe përkrahje					
Kosto e Objektivit Specifik 1.4: 6,800,000 lekë, për periudhën 2025-2028.					
Shënim: Buxheti i siguruar nga të “Ardhurat e veta”, buxheti mesatar I pesë viteve të fundit është 248 milion lekë. Kontributi I kërkuar për projektet e mbështetjes sociale është 2%, pra 5 milion lekë.					
1.4.1. Programi i fuqizimit ekonomik të grave në situatë kritike dhe nevojë për mbështetje					
1.4.2. Program i fuqizimit ekonomik të individëve mbi 18 vjeç, meshkuj, përfutues të NE dhe të punëkërkesve të papunë					
1.4.3. Program i fuqizimit ekonomik, nxitjes së sipërmarrjes dhe vetëpunësimit si edhe formimit profesional të të rinjve					
1.4.1.1.Krijimi i bazës të të dhënave të informacionit mbi tregun e punës dhe sipërmarrjeve në territorin e bashkisë.	Specialist Agjensisë dhe Specialist punësimit	I 3 mujori Parë I 2024	Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"	Bashkia Të ardhura të vetat, Fondet e Pa-kushtëzuar a	Pa kosto
			Ligji 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” Ligji Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”		
1.4.1.2.Organizimi i shërbimit të ndërmjetësimit për punë			Urdhër nr. 624, datë 20.08.2016 “Për miratimin e Planit Operacional për punësimin e anëtarëve në moshë aktive pune të skemës së ndihmës ekonomike 2019-2024	Bashkia Fondi Social	Pa kosto
1.4.1.3.Organizimi i shërbimit të informimit dhe këshillimit për				Fondi Zhvillimit Rajonal	Pa kosto

Kosto e përgjithshme e objektivit 2 : 2,350,000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afati	Baza ligjore	Burimi financimit	Kosto
Objektivi specifik 2.1: Fuqizim të kapaciteteve të institucioneve të qeverisjes vendore në drejtim të rritjes së komunikimit dhe bashkëpunimit me public, komunitetet, grupet e përjashtuara dhe aktorë të tjerë për të krijuar dhe ofruar shërbimeve të qëndrueshme.					
Përfutjes: 5 punonjës të Bashkisë (Seksioni Ndihmës dhe Përkujdesit Shoqëror, Drejtoria/Seksioni i marëdhënieve me publikun) Kosto e objektivit specifik 3.1: 860,000 lekë					
Aktiviteti 2.1.1. Organizim tryezë diskutimi (dy tryeza) me donatorë me qëllim rritjen e bashkëpunimit	3 mujori 1, 2026 3 mujori 1, 2027 3 mujori parë 2028	Drejtoria e ndihmës dhe Shërbimeve Sociale	Numri i projekteve aplikuar Numri i projekteve fituara Raporti i projekteve fituara	I të 13.3.2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave të këshillimor e koordinues institucional, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet	30 pjesëmarrës, 1/2 ditë 80,000/lekë 1 tryezë 160,000 lekë/2 tryeza Çdo 6 muaj gjatë vitit të parë dhe vitit të dytë. Buxheti për të gjithë periudhën 320,000 lekë
Aktiviteti 2.1.2. Program trainimi "Rritja e fondeve nëpërmjet hartimit dhe menaxhimit të projekteve"	Çdo vit	Drejtoria e ndihmës dhe Shërbimeve Sociale	Numri i projekteve aplikuar Buxheti total i projekteve fituara Buxheti total i projekteve fituara krahasim	Bashkia, të ardhurat e veta, Shërbimi Social Shtetëror ASPA Donatorë	3 kurse për 3 vite 4 lektorë në secilin kurs 20 pjesëmarrës Kosto 1 kurs:180,000 lekë Buxheti i përgjithshëm 540,000 lekë. Vlerësim pas çdo trainimi. Vlerësim nëpërmjet pyetësorit individual të

			Buxhetin e Bashkisë (në%)	nevojshme për mbrojtjen e fëmijës". VKM Nr.334, datë 17.2.2011, "Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij"	plotësuar pjesëmarrësit.	nga
Objektivi specifik 2.2: Ndërgjegjësim të komuniteteve të qytetarëve për të drejtat e tyre si edhe mundësitë e realizimit						
Përfutjes: Komunitetet e qytetarëve në nevojë për shërbime sociale						
Kosto e përgjithshme e objektivit 3.2: 630,000 lekë						
Aktiviteti 2.2.1 Organizim programe televizive në TV lokal mbi të drejtat sociale.	Sipas rasteve	Drejtoria për Marëdhënie me Publikun	Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" Ligj Nr.18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës" Ligji Nr.8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e Jetimit" Ligji Nr.8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbërit", Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 "Statusi i invaliditit paraplegjik dhe tetraplegjik" Ligji Nr.7889, datë 14.12.1994, "Statusi i invalidit". Ligji 22/2018 "Për strehimin social" Ligji 47/2018 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"		Pa kosto	
Aktiviteti 2.2.2 Informim i publikut nëpërmjet faqes ëeb të Bashkisë	Mirëmbajtje vazhdimisht	Drejtoria për Marëdhënie me Publikun			Pa kosto	
Aktiviteti 2.2.3 Prodhim dhe shpërndarje të broshurave informative	Vazhdimisht	Drejtoria për Marëdhënie me Publikun		Bashkia, të ardhurat e veta,	Lekë 50,000/vit Buxheti për të gjithë periudhën 150,000 lekë	
Aktiviteti 2.2.4	3 mujori	Drejtoria		Bashkia, të	30 pjesëmarrës,	

Organizim tryeza diskutimi me grupet qytetare mbi bazë komuniteti, në secilën njësi administrative (2 tryeza në secilën Njësi, 6 tryeza)	1,2,3,4 Viti 2026 3 muhori 1, viti 2027	për Marëdhënie me Publikun		ardhurat e veta,	½ ditë Lekë 80,000/1 tryezë Lekë 480,000 (6 tryeza për të gjithë periudhën)
Objektivi specifik 2.3: Ndërgjegjësim të aktorëve dhe operatorëve të biznesit, të shoqërisë civile si edhe të komunitetit ndërkombëtar, për bashkëpunim e partneritet për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të shërbimeve sociale. Përfutjes: Të gjithë aktorët e biznesit privat dhe shoqërisë civile Kosto e përgjithshme e objektivit specifik 3.3.: 160,000 lekë					
Aktiviteti 2.3.1. Ndërtimi i bazës së të dhënave për të gjithë operatorët e biznesit privat në territorin e bashkisë, në qarkun e Fierit si edhe OJF në Bashki dhe në qark.	3 muhori 2, 2027	Drejtoria e ndihmës dhe Shërbimeve Sociale	Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" Ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"		Pa kosto
Aktiviteti 2.3.2. Organizim tryezë diskutimi (dy tryeza) me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë civile dhe sektorit privat	3 muhori 4, viti 2027 3 muhori 3, Viti 2026	Drejtoria e ndihmës dhe Shërbimeve Sociale		Rashkia, të ardhurat e veta,	Lekë 80,000/1 tryezë Lekë 160,000(2 tryeza, një tryezë në fund të vitit të parë dhe 1 tryezë në fund të vitit të dytë.)

Objektiv 3: Fuqizim të kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare, teknike të Bashkisë

Kosto e përgjithshme e Objektivit 3 : 7,060,000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afati	Legjislacioni	Burimi financiarit	Kosto
Objektivi specifik 3.1: Fuqizim të kapaciteteve të Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve si edhe të gjithë seksionit të shërbimeve sociale Përfutjes: 5 punonjës të shërbimeve sociale Kosto totale: 5,400,000 lekë (3 vite)					
Aktiviteti 3.1.1. Rritje e numrit të punonjësve socialë me dy punonjës.	Bashkia, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Financës Këshilli Bashkiak	3 muajori 1, Viti 2026	Vendim nr. 148, datë 13.3.2018 "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimor e koordinues institucional, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave joftimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës". VKM Nr.334, datë 17.2.2011, "Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij"	Bashkia, të ardhurat e veta	1,440,000 në vit 2 punonjës, Paga bruto 60,000 /muaj Buxheti për të gjithë periudhën: 4,320,000 lekë
Aktiviteti 3.1.2 Organizim kurs formimi dhe riformimi profesional për të gjithë punonjësit e bashkisë që operojnë me çështjet e shërbimeve sociale.(kurs 3 ditor, çdo 6 muaj)	Drejtoria e Burimeve Njerëzore Bashkia Shërbimi Social Shtetëror	Çdo 6 muaj		Bashkia, Transfertat e pakushtëzuara, Shërbimi Social Shtetëror ASPA Donatorë	6 kurse për 3 vjet 4 lektorë në secilin kurs 20 pjesëmarrës Kosto 1 kurs:180,000 lekë 360,000 lekë/vit Buxheti për të gjithë periudhën 1,080,000
Objektiv specifik 3.2: Aftësim profesional të ofruesve të shërbimeve sociale. Përfutjes: Ofruesit e shërbimeve sociale të institucioneve publike ose jo publike					

Kosto e përgjithshme: 1,080,000 lekë për të gjithë periudhën e parashikuar të Planit të Veprimit

Aktiviteti 3.2.1 Ndërtimi I bazës të të dhënave të operatorëve të shërbimeve sociale, publikë dhe jo publikë.	3 mujori 1, 2026	Drejtoria e ndihmës dhe Shërbimëve Sociale	Ligj nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë VKM nr. 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".	Bashkia, të ardhurat e veta dhe fondet e pakushtëzuara	Pa kosto
Aktiviteti 3.2.2 Formim profesional cilësor dhe I vazhdueshëm për ofruesit e shërbimeve sociale	Çdo 6 muaj	Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimëve Sociale		Bashkia, të ardhurat e veta, Shërbimi Social Shtetëror ASPA Donatorë	6 kurse për 3 vjet 4 lektorë në secilin kurs 20 pjesëmarrës Kosto 1 kurs: 180,000 lekë 360,000 lekë/vit Buxheti për të gjithë periudhën: 1,080,000lekë
Objektiv specifik 3.3. Krijimi i Fondit Social si instrument i financimit dhe mbështetjes të zhvillimit të shërbimeve sociale. Kosto e përgjithshme: Lekë 580,000, por nuk është përfshirë Buxheti Social në lekë					
Aktiviteti 3.3.1. Vlerësimi I mundësive për krijimin e fondit social nga pikëpamja financiare dhe buxhetore	3 mujori 1, 2026	Drejtoria e Buxhetit Grup ekspertë sh	VKM nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e fondit social". Vendimin nr. 150, datë 20.03.2019 të Këshillit të Ministrave "Për	Bashkia, të ardhurat e veta Donatorë	2 ekspertë, 10 ditë, 25,000 lekë /ditë Lekë 500,000

Aktiviteti 3.3.2 Ndërgjegjësimi qeverisjes vendore dhe këshillit bashkiak mbi nevojën e krijimit të fondit social nëpërmjet organizimit të 2 tavolinave të diskutimit	3 majori 2, 2026	Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale	metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”. VKM nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.	Donatorë	30 pjesëmarrës, ½ ditë Lekë 80,000
Aktiviteti 3.3.3 Krijimi i fondit social dhe përfshirja në PBA	3 majori 3, 2026	Këshilli Bashkiak Patos		Bashkia, të ardhurat e veta	Sipas përcaktimit në VKM

5.3. Plani I Integruar i Monitorimit dhe Vlerësimit

Synimet e formuluara sipas objektivave specifike të secilit objektiv të përgjithshëm.	Baza e nisjes e vlerësimit	Përfitues	Mënyra e vlerësimit	Treguesit e vlerësimit
Objektiv 1 : Përmirësim, zgjerim shërbimesh dhe forcimi i sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashki i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, përkujdesit, integritetit dhe përfshirjes për të gjitha grupet në nevojë, të identifikuar dhe vlerësuara si të tilla, në përputhje me standartet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror.	Viti 2026	1354 Individë mbi 18 vjeç me AK dhe Invalidë”	Raport monitorimi nga ekipi i bashkisë, çdo fundvit.	Numri i individëve që përfitojnë shërbime në familje.
		40 Fëmijë në familje NE, Fëmijë me AK, Fëmijë në nevojë për mbrojtje.	Raport vlerësimi nga ShSSH, Dega Fier.	Niveli i kënaqshmërisë të përfituesve të shërbimit dhe familjareve të tyre.
		700 të moshuar.		Niveli i kualifikimit të ofruesve të shërbimit.
		17 gra në nevojë kritike, të përjashtuara ose në rrezik përjashtimi.		Niveli i zbatimit të standarteve të shërbimit.
		316 individë të tjerë, përfitues të NE	Raport Vlerësimi përfundimtar nga ekipi i bashkisë si edhe ekspertëve të jashtëm, 6 muaj përpara përfundimit të afatit të planit Nëntor-Dhjetor 2027	Numri i shërbimeve të reja të krijuara. Kapaciteti i tyre si edhe shkalla e plotësimit të kapacitetit.
		452 punëkërkues të papunë		Shpërndarja gjeografike e shërbimeve dhe mundësia e individëve në nevojë për të aksesuar
		90 të rinj të papunë, në rrezik përjashtimi, në konflikt me ligjin,		

		në nevojë për mbrojtje dhe përkrahje.		shërbimin. Numri i qytetarëve që përfitojnë shërbime/Numri i qytetarëve që kanë nevojë për shërbime. Numri i individëve që kanë përfituar nga programet e riintegritimit të bashkisë. Numri i individëve që kanë përfituar nga programet e ri integritimit/numri i individëve që kanë kërkuar mbështetje nga bashkia. Fondi i nxitjes së sipërmarrjes, masa dhe efijensa e përdorimit të tij.
Objektiv 2: Krijimi i një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon individët dhe grupet në nevojë kritike për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore,		Bashkia e Patos, punonjës të drejtorive që mbështesin Drejtorinë e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit Komunitetet e	Raport vlerësimi nga ShSSH, Dega Fier.	Numri i tryezave të diskutimit të organizuara, sipas tematikave dhe sipas grupeve të pjesëmarrësve. Numri i kurseve të formimit, si edhe sipas tematikave. Niveli i

shëndetsore apo autonomia e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive, në përputhje të plotë me nevojat dhe mundësitë e bashkisë.		qytetarëve si edhe komunitetet e individëve të përjashtuar.	Raport Vlerësimi përfundimtar nga ekipi i bashkisë si edhe ekspertëve të jashtëm, 6 muaj përpara përfundimit të afatit të planit, Nëntor-Dhjetor 2027	kënaqshmërisë të pjesëmarrësve në kurset e formimit. Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të komuniteteve, të grupeve të përjashtuara, të sektorit privat dhe jo fitimprurës. Numri i bashkëpunimeve me sektorin privat dhe jo fitimprurës. Shërbimet e ngritura si rrjedhojë e bashkëpunimit me grupe të reja aktorësh.
Objektiv 3: Fuqizim të kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare, teknike të Bashkisë		Bashkia Patos, Drejtoria e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit Punonjësit e rinj të shtuar në sektorin/drejtorinë e shërbimeve sociale, gjithsej dy punonjës. Punonjës të drejtorive të tjera që bashkëpunojnë me sektorin/drejtorinë e shërbimeve sociale, gjithsej	Raport vlerësimi nga ShSSH, Dega Fier. Raport Vlerësimi përfundimtar nga ekipi i bashkisë si edhe	Transformimi i sektorit në drejtori të shërbimeve sociale. Numri i punonjësve të shtuar, në përputhje me specifikimet ligjore, përkatësisht për NjMF si edhe shërbimet në përgjithësi. Krijimi i NjVNR Aktivizimi i sistemit MIS. Numri i kurseve të formimit dhe

		15 punonjës. Punonjës të institucioneve të tjera, të varura ose jo nga bashkia, që mbështesin bashkinë në realizimin e objektivave të planit social.	ekspertëve të jashtëm, 6 muaj përpara përfundimit të afatit të planit Nëntor-Dhjetor 2027	reformimit profesional për të gjithë punonjësit e bashkisë që operojnë me çështjet e shërbimeve sociale, si edhe sipas tematikave. Numri i pjesëmarrësve dhe sipas funksioneve. Niveli i kënaqshmërisë të pjesëmarrësve në kurset e formimit. Rritja e shkallës së profesionalizmit si rrjedhojë e pjesëmarrjes në kurset e formimit. Fondi Social/Ardhurat e veta Numri i projekteve të financuara nga fondi social. Numri i projekteve të aplikuara/të financuara.
--	--	--	--	---

GRUPI I PUNËS


Drejtores e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit

Elda Goxhaj




Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social

Barie Goxhaj




Specialiste e Mbrojtjes së Fëmijëve

Fabjola Hoxha



Specialiste e Mbrojtjes Sociale

Lediana Begiri




Administrator Social Njësia Ruzhdie

Xhemil Muçaj

Administratore Sociale Njësia Zharrëz

Rovena Dine



KRYETARI

Fation Duro

NËNUNGJES DHE HE
ARDHER
Ish Sauti

